



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Luhjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 585/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092), në përbërje nga Agon Ramadani- Kryetar, Vedat Poterqoi- Anëtar dhe Kimete Gashi- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "Activa Group sh.p.k", me seli në Suharekë, kundër njoftimit mbi vendimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi dhe rregullimi i varrezave në qytet", me nr. të prokurimit, 624-22-9619-5-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna Suharekë, me datën 18.01.2023, morri këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet** si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Activa Group sh.p.k", me seli në Suharekë, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 25.10.202 (me numër protokolli 585/2022) për aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi dhe rregullimi i varrezave në qytet", me nr. të prokurimit, 624-22-9619-5-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna Suharekë.

II. **Anulohet**, njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi dhe rregullimi i varrezave në qytet", me nr. të prokurimit, 624-22-9619-5-2-1, dhe lënda kthehet në rivlerësim

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj Panelin Shqyrtues të OSHP, për gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, i përshkruar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi. Në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (versioni i konsoliduar).

IV. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: "Activa Group sh.p.k", me seli në Suharekë, i refuzohet si e pabazuar, i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 12.10.2022, AK Komuna Suharekë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin mbi vendimin për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi dhe rregullimi i varrezave në qytet”, me nr.të prokurimit,624-22-9619-5-2-1.

Me datën 17.10.2022, Operatori Ekonomik “Activa Group sh.p.k”, me seli në Suharekë, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim për aktivitetin e prokurimit të cekur më lartë, ndërsa me datë 20.10.2022,AK Komuna Suahrekë, ka publikuar vendimin me të cilin ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim OE ankues si të pa bazuar dhe ka vërtetuar njoftimin mbi vendimin e AK të datës 12.10.2022.

Me datën 25.10.2022 Operatori ekonomik,“Activa Group sh.p.k”, ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 585/2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, punë vlera e parashikuar e kontratës 223.000.00 €

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe e njëjta bije nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 04.11.2022, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar,
- aktiviteti i prokurimit të lartë shënuar të kthehet në rivlerësim.

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtruesat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha provave, deklarimeve, dhe të dhënave të cilën janë pjesë përbërëse e kësaj ankese, Paneli Shqyrtues konstaton se në relacion me pretendimet ankimore objekt i ankesës është vendosur se do të përcaktohet tek dy pretendime që PSH konsideron që luajnë rol kyç për të arritur deri tek rezultati përfundimtar sikurse në dispozitiv, kështu që nuk do të trajtohen pretendimet tjera ankimore për shkakun se në këtë rast shqyrtimi i tyre nuk do të jepte ndonjë rezultat tjetër edhe sikurse të klasifikoheshin të bazuara, gjithashtu lidhur me këto pretendime, PSH mbështetet në raportin e ekspertizës dhe konsideron se vendosja lidhur me gjetjet e tij është arritur konform ekspertizës.

Lidhur me këtë, PSH konstaton se pikat kyçe përcaktuese qëndrojnë tek përmbushja e kërkesës nr 2 në DT, që si kërkesa kualifikuese janë objekt i pretendimeve ankimore për të cilën kontestohet përmbushja e tyre si nga OE ankues, e poashtu nga OE i rekomanduar për kontratë, kjo kërkesë dhe dëshmia e kërkuar relevante janë si në vijim:

- “Kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik, në veçanti të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projektit. Stafi i kualifikuar në fushën përkatëse, se paku një Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë Drejtimi i infrastrukturës rrugore që ka tri vite përvojë pune pas diplomimit, Inxhinier i Ndërtimtarisë drejtimi Konstruktiv që ka tri vite përvojë pune pas diplomimit, një arkitekt që ka tri vite përvojë pune pas diplomimit”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: “Kontrata e punës ose para kontrata me inxhinierët, Diploma e Noterizuar, dokument dëshmi mbi përvojën e punës dhe një CV”.

Një nga arsyet e eliminimit të OE ankues bazuar në vendimin e AK-së ka qenë mos-përmbushja e kësaj kërkesë nga OE ankues, PSH konstaton se lidhur me këtë kërkesë AK ka eliminuar me arsyen (citoj): mungojnë inxhinjerat, (inxhinjeri i ndërtimtarisë drejtimi i Infrastrukturës rrugore dhe inxhinjeri i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv, siç janë kërkuar me dosje të tenderit.”

Paneli shqyrtues, vlerëson se për plotësimin e kësaj kërkesë të DT-së, OE ankues ka ofruar inxhinierin e ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv z. Haxhi Krasniqi, për të cilin janë paraqitur edhe dëshmitë relevante kështu që kërkesa lidhur me këtë inxhinier PSH konstaton se plotësohet, mirëpo lidhur me dy inxhinierët tjerë PSH në ofertën e OE ankues nuk ka evidentuar të dhëna që dëshmojnë paraqitjen e tyre, konkretisht lidhur me inxhinierin e infrastrukturës rrugore, PSH konform raportit të ekspertizës konstaton se në ofertën e tij OE ankues nuk ka paraqitur informata se posedon inxhinier të tillë. Ndërsa lidhur pretendimin e OE ankues se është dashur të kërkohen sqarime sipas nenit 72, PSH konsideron se në nenin 72.3 të LPP-së është e saktësuar që kërkesa për sqarime apo sigurimi i informacioneve mund të behet vetëm për dokumente ekzistenca e të cilave është e fiksuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive, ndërsa në rastin konkret inxhinieri nuk është ofruar fare dhe sikur të kërkohej sqarime dhe të ofrohej do të paraqiste ndryshim material dhe nuk mund të verifikohet ashtu siç e parasheh dispozita e Nenit 72.3. Andaj pretendimi i OE ankues në këtë pikë klasifikohet si i pa bazuar.

Nga se çka u tha më sipër, Paneli Shqyrtues konstaton se oferta e OE ankues “Activa Group sh.p.k” lidhur me këtë aktivitet prokurimi klasifikohet **si e papërgjegjshme**, e poashtu OE ankues **eliminohet** nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në këtë aktivitet (përfshirë në procedurat e rivlerësimit).

Gjithashtu OE ankues “Activa Group sh.p.k”, pretendon se AK ka rekomanduar për kontratë një OE të papërgjegjshëm sepse i njëjti nuk plotësuar kërkesën e njëjtë të lartcekur në këtë vendim, duke ofruar një diplomë të inxhinierit të

infrastrukturës rrugore, i cili ka diplomuar me datën 24.06.2021 e që nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Lidhur me këtë pretendim të OE ankues Paneli Shqyrtues konstaton që bazuar në të dhënat e paraqitura, OE i rekomanduar për kontratë për plotësimin e kërkesës së DT-së lidhur me inxhinier të infrastrukturës rrugore ka ofruar z.Lekë Krasniqi, për të cilin si dëshmi është ofruar diplomë Masteri nga Kolegji UBT që dëshmohet se i njëjti është diplomuar në infrastrukturë rrugore, në këtë diplomë data e mbrojtjes së tezës së punimit është 24.06.2021, pra nga data e diplomimit të inxhinierit deri tek njoftimi për kontratë rezulton të jenë më pak se tre vite përvojë pune pas diplomimit dhe se i njëjti nuk ka arritur të përmbushë kërkesën e dosjes së tenderit, si dhe arsyetimi i dhënë nga AK se i njëjti përmbush kërkesën për faktin se përvojën e punës e dëshmon në bazë të CV-së së paraqitur sipas PSH nuk qëndron për faktin se kërkesë në DT është që përvoja prej 3 viteve të jetë “pas diplomimit”, andaj rrjedhimisht pretendimi i OE ankues në këtë pikë klasifikohet si i bazuar.

Andaj bazuar në faktet dhe arsyet lidhur me këtë pretendim ankimor, Paneli Shqyrtues konstaton se oferta e OE të rekomanduar “Flori sh.p.k” lidhur me këtë aktivitet prokurimi klasifikohet **si e papërgjegjshme**, e poashtu OE i rekomanduar **eliminohet** nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në këtë aktivitet (përfshirë në procedurat e rivlerësimit).

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me konstatimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Paneli Shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Agon Ramadani



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Komuna Suharekë

1x1 OE "Activa Group sh.p.k" me seli në Suharekë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-s